



Pranuar / Datede Prilapen / Prilapito Received / Delivered			22. 02 2021	1	viti god year
Organ / Shista Organ / Shista Org / Unit	Id. Pror. Id. Pror. Pror. No.	Shtojca Puleg Appendix	Sasia Kohema Quantity		
SKPM/SHCK	757/2021		113		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.09/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare e Kolegjit, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.09/2021 të datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesit:

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson av. me adresë rruga "Afrim Zhitia", p.n, Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 22.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.05/2021 të datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesit:

dhe

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**A r s y e t i m**

Ankuesit

te punësuar ne Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes avokatit av.Leotrim Ademi, me datën 25.11.2020, kanë parashtruar kërkesë për njohjen/pagesën e shujtës ushqimore për të punësuarit.

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", lidhur me kërkesën e ankuesve për njohjen/pagesën e shujtës ushqimore, nuk ka kthyer përgjigje.

Te pakënaqur me mos shqyrtimin lidhur me kërkesën e tyre, nga ana e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre av. përmes Postës së Kosovës me datën 05.01.2021, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar në Këshill me datën 08.01.2021 dhe është protokolluar me numër të protokollit 49/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 12.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Me datën 11.02.2021, Këshilli përmes e-mailit zyrtar ka pranuar përgjigje në ankesë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.01.2021 me Nr.Prot:49/2021 e parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 16.07.2019; Kërkesë për njohjen/pagesën e shujtës ushqimore për te punësuarit e datës 25.11.2020, drejtuar Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 12.01.2021; Përgjigja në ankesë përmes e-mailit zyrtar e datës 11.02.2021; Akt emërim i datës 12.12.2011 me numër Ref.nr.4/60 për ankuesen Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.1/577 për ankuesin Akt emërim i datës 03.09.2012 me numër Ref.nr.2/401 për ankuesen Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.1/596 për ankuesin Akt emërim i datës 02.02.2012 me numër Ref.nr.1/580 për ankuesen Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.1/589 për ankuesin Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.1/579 për ankuesen Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.1/588 për ankuesin Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.1/499 për ankuesin Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.773 për ankuesen Akt emërim i datës 20.02.2012 me numër Ref.nr.849, për ankuesen

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit

dhe

sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit -Universiteti i Prishtinës, ka konstatuar se: sipas Ligjit, Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 përcaktohet se: **4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike,** dhe si



rrjedhje ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, respektivisht në Universitetet Publike, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesit tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përkasin kategorisë së nëpunësve të *Shërbimit Publik*, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.


Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve, udhëzon palët për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 74 si dhe nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente*".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.05/2021

Hysni Mustafa  
  
Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari  
  
Kryetare e Kolegjit  


**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve at
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Universitetin e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

